



6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1862/11 Prot

Elbasan më 30 /04/2020

**VENDIM**

Nr 41 datë 30/04/2020.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Mars 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MARS 82 familje me fond 270.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1863/11 Prot

Elbasan më 30/04/2020

**VENDIM**  
Nr. 42 datë 30/04/2020

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MARS 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **MARS 2020** gjithsej 122 familje me një fond prej 378.800 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Ciftja





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1864/prot.

Elbasan më 30/04/2020

VENDIM

Nr. 44 datë 30/04/2020

“Për Ndryshim Strukture dhe Transferim Fondesh”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës...../...../2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore e Bashkisë për kalimin e sektorit të Agronomisë nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisor në Agjensinë e Shërbimeve Publike, me kërkesë të Agjensisë së Shërbimeve Publike; bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij, ligjin 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 40;

Vendosi

- 1- Sektori i Agronomisë nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisor të kalojë në Agjensinë e Shërbimeve Publike.
- 2- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve publike të jetë 258 punonjës.
3. Transferimin e fondeve nga të ardhurat, për periudhën maj- dhjetor 2020, si më poshtë :

**Paksohet :**

Prog	Kap.	Art.	Shuma/lekë	Njësia Shpenzuese
04220	5	600	4,350,000	Bashkia
04220	5	601	700,000	Bashkia
			<b>Gjithsej : 5,050,000</b>	

**Shtohet :**

Prog	Kap.	Art.	Shuma/lekë	Njësia Shpenzuese
04220	5	600	4,350,000	ASHP
04220	5	601	700,000	ASHP
			<b>Gjithsej : 5,050,000</b>	